



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



D.P.SH. "Eagle"
Rr. Haki Taha nr.101
Prizren

Vendimi LIC/CO-CIMC: 2008/02
Ref: 0805/0710/LIC/11

VENDIM

lidhur me aplikacionin për licencë të operatorit kabllorë D.P.SH "Eagle" - Prizren

Fakte

1. Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media (KPM), duke vepruar në bazë të Nenit 2.5 dhe Nenit 11 të Ligjit për KPM-në Nr. 02/L-15 ka nxjerr Rregulloren e Distribimit Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë (CIMC 2007/04) e cila ka hyrë në fuqi më datë 06 korrik 2007.
2. Në bazë të Nenit 5 të Rregullores CIMC 2007/04, operatorët aktivë kabllorë kanë qenë të obliguar të regjistrohen një muaj pas miratimit të kësaj rregulloreje, ndërsa tre muaj më vonë kanë qenë të obliguar të aplikojnë për licencë të KPM-së.
3. Më 20 gusht 2007 Operatori kabllor D.P.SH. "Eagle", është regjistruar në zyrën e KPM-së si operatorë kabllorë aktiv i cili operon në Prizren ndërsa ka aplikuar për licencë të KPM-së për operatorë kabllorë më 15 prill 2008.

Arsyetim

4. Në pajtim me Nenin 5 të Rregullës CIMC 2007/04 operatori kabllor D.P.SH. "Eagle" ka paraqitur të dhëna të mjaftueshme për regjistrim në KPM si operator kabllor aktiv.

5. Në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullës CIMC 2007/04 operatori kabllor D.P.SH. "Eagle" ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator kabllor.
6. Me Rregulloren për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator kabllor, prandaj Këshilli i KPM-së vlerëson se një operator kabllor mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve nëse ai posedon marrëveshjet valide për ritransmetimin e atyre programeve.
7. Operatori kabllorë D.P.SH. "Eagle" do të ketë të drejtë të bart në pakon e tij vetëm programet televizive për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllor.
8. Nëse pas marrjes së licencës, operatori kabllor D.P.SH. "Eagle" siguron marrëveshje shtesë/të reja për ritransmetimin e programeve në rrjetin kabllor, KPM, pas pranimit të kontratave të reja, do të zgjerojë listën e programeve për të cilat e ka licencuar. Operatori kabllor D.P.SH. "Eagle" obligohet t'i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja, sapo t'i ketë siguruar ato.
9. KPM vlerëson se D.P.SH. "Eagle" ka paraqitur aplikacionin brenda afatit të përcaktuar nga ana e Këshillit të KPM-së në pajtim me kriteret e përcaktuara me Rregulloren CIMC 2007/04.
10. Prandaj, KPM vlerëson se në bazë të nenit 6 të Rregullores CIMC 2007/04 operatori kabllor D.P.SH. "Eagle" ka përmbushur kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

Vendim

11. KPM konkludon se D.P.SH. "Eagle" ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve kabllore përmes sistemit kabllor në Prizren.
12. KPM vendos që operatorit kabllor D.P.SH. "Eagle", i cili operon në Prizren, t'i lëshoj licencën e KPM-së për të ofruar përmes sistemit kabllor shërbime të programeve kabllore për të cilat posedon marrëveshje për ritransmetim të kanaleve përmes rrjetit kabllor.
13. Në bazë të Nenit 3.2 të Rregullores për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë, licenca e operatorit kabllor D.P.SH. "Eagle" do të jetë valide për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi vazhdimi nga ana e KPM-së.
14. Në pajtueshmëri me Nenin 10 të Rregullores CIMC Nr. 2007/4, çdo operator kabllor duhet të paguajë taksën vjetore. Niveli i taksës vjetore për licencim të Operatorëve Kabllor është i përcaktuar me Nenin 3.1 të Vendimit për Nivelin,

Mënyrën e Përcaktimit të Pagesës së Takës për Licencim të Operatorëve Kabllor dhe Ofruesve të Shërbimeve të Programeve përmes Kabllos (CIMC 2007/05).

15. Në pajtueshmëri me Nenin 6.2 të Vendimit (CIMC 2007/05), operatori kabllor D.P.SH. "Eagle" duhet ta paguaj taksën e parë vjetore për licencë jo më vonë se 14 ditë pas pranimit të Licencës.

Lëshimi i Vendimit

16. Këtë vendim e lëshon Këshilli i KPM-së.

Argjentina Grazhdani
Kryesuese e Këshillit të KPM-së.


29/05/08

datë

Vërtetim

Me këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.

Naile Selimaj Krasniqi
Shefe Ekzekutive



29.05.08

datë